

4. KONTROLLI I BRENDSHËM

Kontrolli i brendshëm në Bankën e Shqipërisë realizohet nga Departamenti i Kontrollit. Objektivi kryesor i tij është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Funkzioni i kontrollit u siguron Administratorëve të Bankës, në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar kontrollet dhe procedurat e caktuara, por duke mos qenë një zëvendësues i tyre.

4.1. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË AKTIVITETIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM


A. Vënia në zbatim e Politikës së sapomiruar të Auditimit të Brendshëm

Me miratimin e politikës së parë të Auditimit të Brendshëm dhe rishikimin e rregullores së funksionimit të Departamentit të Kontrollit, hyri në fuqi mënyra e re e procesit të **shqyrtimit dhe miratimit të planit vjetor të Auditimit të Brendshëm** në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Plani vjetor për vitin 2016 u hartua nga Departamenti i Kontrollit dhe Inspektori i Përgjithshëm dhe u paraqit për shqyrtim nga Komiteti i Auditimit. Më tej, ky plan i dakorduar nga Komiteti i Auditimit u paraqit në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, ku u miratua me vendimin nr.9 të datës 03.02.2016.

B. Miratimi i Metodologjisë për vlerësimin e rrezikut për nevoja auditimi

Prej vitit 2013, Departamenti i Kontrollit ka draftuar një metodologji të re për vlerësimin e rrezikut për qëllime auditimi, e cila ka qenë paralelisht në fazë testimi me metodologjinë ekzistuese të vlerësimit të rrezikut. Me realizimin e vlerësimit të jashtëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm (*External Quality Assessment EQA* - Korrik 2015), si dhe me rishikimet e propozuara nga Inspektori i Përgjithshëm gjatë rishikimit të procedurave të auditimit të brendshëm, kjo **metodologji u plotësua** me elementin "Mjedisi i jashtëm" - një rrezik për t'u vlerësuar gjatë planifikimit për çdo funksion në lidhje me ndikimin që ka mjedisi i jashtëm ligjor / rregullativ në funksionin/procesin e audituar. Ky element përbën edhe **një nga burimet e rrezikut operacional**, i cili u trajtua gjerësisht gjatë projektit për implementimin e Kuadrit të Administrimit të Rrezikut Operacional në nivel banke.

Kjo **metodologji u miratua nga Inspektori i Përgjithshëm** dhe u komunikua pranë Administratorëve dhe Komitetit të Auditimit me shkresën nr.5643 datë



07.12.2016. Plani i aktivitetit për vitin 2017 është bazuar mbi vlerësimet e rrezikut të funksioneve të universit të auditimit të mbështetura në metodologjinë e re të vlerësimit të rrezikut për qëllime auditimi.

C. Finalizimi i prokurimit të aplikacionit për auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut

Në muajt nëntor-dhjetor, Departamenti i Kontrollit në bashkëpunim me Departamentin e Administrimit finalizuan procedurën e prokurimit të rinisur në prill 2016 për **blerjen e një aplikacioni për menaxhimin e automatizuar të auditimeve dhe të procesit të menaxhimit të rrezikut operacional**. Pas disa vitesh inicimi dhe dështimi të procedurave për përfundimin e një *software*-i të tillë, Banka e Shqipërisë finalizoi procesin e blerjes, duke përzgjedhur një nga ofruesit më seriozë dhe më të vlerësuar në fushën e auditimit të brendshëm dhe të përdorur nga shumë banka qendrore. Viti 2017 do të nisë me implementimin e aplikacionit, trajnimin e stafit për përdorimin dhe popullimin e aplikacionit me të dhënat historike të Auditimit të Brendshëm dhe Rrezikut Operacional.

D. Vendosja dhe funksionimi i marrëdhënieve me njësinë e re të sapokrjuar ARO

Me krijimin e njësisë së re pranë Inspektorit të Përgjithshëm për Administrimin e Rrezikut Operacional (ARO), plotësimin e strukturës me 2 specialistë, si dhe me miratimin e Politikës për Administrimin e Rrezikut Operacional dhe Rregullores së funksionimit të kësaj njësie u **vendosën linjat e raportimit dhe bashkëpunimit** midis Njësisë së re dhe Departamentit të Kontrollit për përmbushjen e objektivave të secilës palë.

E. Inicimi i projektit të radhës me rëndësi MVV (BCM) - Vijueshmëria e Veprimtarisë

Me propozim të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë në komunikimin e datës 10.06.2016 për Inspektorin e Përgjithshëm, në vijim të takimit të Administratorëve mbi përmbushjen e rekomandimeve të adresuara nga Audituesi i Jashtëm, FMN, BQE etj., njësia ARO u caktua si përgjegjëse për iniciimin dhe ndjekjen e punës për implementimin e Programit për Menaxhimin e Vijueshmërisë së Veprimtarisë në Bankën e Shqipërisë.

Në kuadër të **vijimit të një pune me shumë vlerë të shtuar për Bankën e Shqipërisë nga Departamenti i Kontrollit në vitin 2013** për vlerësimin e gjendjes aktuale të Vijueshmërisë së Veprimtarisë në BSH, ku u adresua angazhimi i parë i këshillimit për vlerësimin e nivelit të MVV-së së BSH-së kundrejt një standardi ndërkombëtar në fushën e MVV-së, në nëntor - dhjetor 2016 u punua për përzgjedhjen, organizimin dhe krijimin e Grupit të Punës, që do të realizojë **projektin për hartimin dhe implementimin e MVV-së në Bankën e Shqipërisë**. Grupi Drejtues i përbërë nga Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional së bashku me 2 përfaqësues nga DK-ja, njëkohësisht vlerësuesit e gjendjes



aktuale të MWV-së në vitin 2013, vlerësoi dhe analizoi fazat aktuale të projektit dhe afatet kohore të domosdoshme për përmbushjen me sukses të tij.

Tashmë, me një kulturë më të rritur risku dhe dizenjimi/evidentimi të proceseve të punës nga të gjitha njësitë e BSh-së, projekti për Vijueshmërinë e Veprimtarisë ka bazën e nevojshme për të zhvilluar etapat e parashikuara në planin e projektit, të cilat së bashku me angazhimin e secilës njësi mund të garantojnë një përmbushje të suksesshme të objektivave.

F. Implementimi i rekomandimeve të vlerësuesve të jashtëm

Në vijim të rezultateve dhe plotësisë së standardeve të Auditimit të Brendshëm vlerësuar nga Banka Qendrore e Holandës në maj të vitit 2015, Departamenti i Kontrollit plotësoi ndryshimet e mundshme në bazën rregullative, duke vënë në zbatim planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga vlerësuesi i Jashtëm (EQA). Në vijim të këtij procesi, **janë akoma në proces 3 rekomandime** - njëri nga të cilët lidhet me ndryshimin e ligjit të Bankës Shqipërisë për ndryshimin e emrit nga Departamenti i Kontrollit në Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Aktualisht, në lidhje me këtë mungesë të ligjit nga i cili ishin dhe një sërë rekomandimesh të tjera, u rishikuan të gjithë termit në bazën rregullative për të aplikuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (IPPF). Në vijim, tabela tregon situatën në fund të vitit 2016 lidhur me rekomandimet e vlerësuesve të Jashtëm (EQA) realizuar nga Banka Qendrore e Holandës:

Nivelet e përputhshmërisë sipas EQA	Standardet e vlerësuara gjatë EQA sipas nivelit të përputhshmërisë (2015)	Statusi i vlerësimit 2016 pas Planeve të Veprimit
Nuk përputhet	14	0
Përputhet pjesërisht	29	3
Përputhet	61	101
TOTALI	104	104

Sipas paraqitjes së mësipërme, vetëm 3 standarde nuk janë plotësisht të zbatuara (në përputhje me praktikën më të mira të parashikuara nga IPPF-ja e Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm).


TREGUES TË PËRGJITHSHËM MBI DEPARTAMENTIN E KONTROLLIT

Në përputhje me Ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", objektivi kryesor i Departamentit të Kontrollit është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të veprojë si një masë kontrolli e përgjithshme dhe shërbim konsulence për Administratorët dhe Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë ndihmesën e tij në drejtim të ruajtjes së integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.




A. Struktura organizative e Departamentit të Kontrollit

Bazuar në ndryshimet strukturore të Bankës së Shqipërisë të miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.87, datë 02.12.2015, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe Departamenti i Kontrollit pësuan ndryshime (a. shtimi në strukturë i pozicionit të Zëvendës drejtuesit, b. krijimi i njësisë së Administrimit të Rrezikut Operacional). Aktualisht, struktura organizative e drejtuar nga Inspektori i Përgjithshëm është pothuajse e plotë dhe me burimet e nevojshme për t'u angazhuar. Viti 2016 shënoi vitin e plotësimit dhe vënies në funksion të pothuajse gjithë strukturës së re.



B. Rritja profesionale e stafit dhe trajnimi i vazhdueshëm

Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe trajnimi për auditimin e brendshëm dhe për menaxhimin e rrezikut të ofruara nga bankat qendrore dhe njëkohësisht kanë ndjekur programe individuale për zhvillimin e tyre profesional dhe për dhënien e provimeve profesionale për anëtarësime/certifikime pranë institucioneve ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit, financës dhe auditimit. Gjatë vitit 2016, inspektorët e kontrollit kanë iniciuar dhe vijuar ndjekjen e programeve për certifikimet profesionale ACCA, CIA, CISA, si dhe kanë ndjekur orët minimale të detyrueshme për mirëmbajtjen e titujve CIDA, ACCA dhe KM.



ANGAZHIMET E KRYERA GJATË VITIT 2016 DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2016 janë fokusuar: (i) në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme të vendosura nga Drejtimi për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve; dhe (ii) në dhënien e opinionit mbi saktësinë dhe plotësinë e të dhënave financiare në raportimet katërmujore (raportimet monetare pranë FMN-së), si dhe në angazhime të tjera audituese dhe joaudituese të paplanifikuara me kërkesë të veçantë nga Administratorët apo institucione të tjera jashtë Bankës.

Gjatë vitit 2016, u adresuan gjithsej 98 rekomandime të rezultuara nga angazhime auditimi për dhënie sigurie, pa përfshirë sugjerime të rezultuara nga angazhime këshillimi me kërkesë të veçantë nga Administratorët. Gjetjet dhe rekomandimet për secilin prej auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njësive për komente dhe më pas pranë Administratorëve të Bankës së Shqipërisë. Janë adresuar gjithsej 15 raporte auditimi nga të cilat 9 angazhime për dhënie sigurie, 4 angazhime të vazhdueshme për opinion mbi saktësinë e të dhënave raportuar pranë FMN-së dhe 2 angazhime investigimi me kërkesë të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

4.2. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME TË ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT OPERACIONAL NË NIVEL BANKE

A. Implementimi i Kuadrit të Menaxhimit të Rrezikut Operacional për Bankën e Shqipërisë

Në mesin e vitit 2015, si pjesë e rekomandimeve të përsëritura të Institucioneve Ndërkombëtare (FMN, BQE, FSVC, BB) u iniciua projekti për implementimin e rrezikut operacional në nivel banke. Praktika e suksesshme e identifikimit, vlerësimit dhe ndjekjes së rreziqeve operationale në procesin e Administrimit të Rezervës Valutore, synohej të shtrihej në të gjitha funksionet dhe proceset e Bankës së Shqipërisë në projektin me afat deri qershorin e vitit 2016.

Grupi i punës i krijuar për këtë qëllim me 4 anëtarë, në të cilin marrin pjesë 2 përfaqësues nga Departamenti i Kontrollit (Zëvendësdrejtori dhe një inspektor kontrolli) zhvilloi gjatë periudhës maj 2015 – qershor 2016 implementimin e etapave të mëposhtme:

- Faza I – Organizim, informimi dhe parapërgatitja e njësive dhe koordinatorëve
- Faza II - Identifikimi i proceseve dhe hartimi i skemës së proceseve për çdo departament.
- Faza III – Hartimi i matricës së proceseve për gjithë bankën.



- Faza IV – Udhëzimi mbi identifikimin e rreziqeve operacionale për çdo njësi.
- Faza V – Përcaktimi i rreziqeve kryesore nga çdo njësi.
- Faza VI - Vlerësimi i rrezikut në nivel banke.
- Faza VII - Kuadri rregullativ.
- Faza përfundimtare – Raporti përfundimtar i projektit ORM.

Viti 2016, në lidhje me implementimin e kuadrit të plotë për administrimin e rrezikut operacional në nivel Banke, njohu disa zhvillime të rëndësishme:

- Finalizimi i 3 etapave të rëndësishme të implementimit të rrezikut operacional – Harta e proceseve, harta e rreziqeve dhe vlerësimi i rreziqeve; Aktualisht, grupi i punës, pas finalizimit të të gjithë anës operacionale të projektit, përgatiti raportin përfundimtar së bashku me rezultatet e agreguara, propozimet për implementim dhe vijimësi, si dhe draftimin e kuadrit rregullativ.
- Plotësimi i strukturës Organizative të Njesisë së Administrimit të Rrezikut Operacional me dy specialistë për rrezikun operacional, gjatë muajit mars – prill 2016. Gjatë kësaj periudhe, dy specialistët u aftësuan me etapat e ndjekura nga grupi i punës së ORM-së, metodologjia e përdorur, rezultatet sipas fazave dhe njohja me rezultatet e këtij vlerësimi të parë në nivel banke të rrezikut operacional.

B. Politika e Administrimit të Rrezikut Operacional

Në përfundim të projektit të ARO, Grupi i Punës dhe Zyra për Administrimin e Rrezikut operacional pranë Inspektorit të Përgjithshëm, hartuan dhe propozuan për miratim, aktet e mëposhtme rregullative:

- Miratimi i Politikës së Administrimit të Rrezikut Operacional, nëpërmjet shprehjes së qartë të parimeve bazë, objektit/fushës së Administrimit të Rrezikut Operacional në Bankë, si dhe përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi të të gjitha strukturave qeverisëse të Administrimit të RO-së;
- Miratimi i Metodologjisë për ARO-n, Rregullores dhe manualeve të vendit të punës të Njesisë së ARO-s;

Politika e administrimit të rrezikut operacional ka për qëllim krijimin dhe zbatimin e një kuadri efektiv dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë në përputhje me praktikat më të mira dhe aktet rregullative. Nëpërmjet kësaj politike do të përcaktohen parimet bazë për identifikimin, vlerësimin, kontrollin, administrimin dhe ndjekjen e rrezikut operacional në një proces të integruar në nivel banke.



Parimet e ARO-s sipas grupit SIG Operational Risk Subgroup të BIS dhe IORWG⁴⁸ paraqiten në politikë. Parimet bazë të Administrimit të Rrezikut Operacional kanë të bëjnë me: qartësinë e përgjegjësive, kulturën, motivimin, ndërgjegjësimin, cilësitë e kuadrit rregullativ, ndjekjen, raportimin, rishikimin periodik, transparencën dhe konfidencialitetin.

Qeverisja e Rrezikut Operacional – Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratorët

KM-ja dhe Administratorët duhet të sigurojnë se ka një kuadër efektiv dhe të integruar për administrimin e rrezikut operacional. Kjo duhet të përfshijë një strukturë organizative të mirëpërcaktuar me role dhe përgjegjësi të qarta për të gjitha aspektet e administrimit/monitorimit të rrezikut operacional dhe mjetet e duhura që mbështesin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe raportimin e rreziqeve operationale.

Mjedisi i Administrimit të Rrezikut – Identifikimi & Vlerësimi, Monitorimi & Raportimi, Kontrolli & Zbutja, Vijueshmëria

Duhet të implementohet një proces për të monitoruar rregullisht profilet e rrezikut operacional dhe ekspozimet materiale ndaj humbjeve, si dhe mekanizmat e përshtatshëm për raportimin pranë KM-së, Administratorëve dhe njësisë që mbështesin administrimin proaktiv të rrezikut operacional.


Përgjegjësia për Raportim dhe Transparencë

Raportimet periodike të Bankës duhet t'i mundësojnë të gjitha palëve të përfshira të vlerësojnë qasjen e Bankës ndaj rrezikut operacional.

Objektivat e ARO-s kanë të bëjnë me: identifikimin e problematikeve të funksioneve dhe proceseve, rritjen e eficiencës së burimeve njerëzore, minimizimin e humbjeve, parandalimin e humbjeve, ndihmesën në qartësimin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive. Sipas praktikave më të mira, Programi i ARO-s kalon në mënyrë ciklike në disa faza:

- Identifikimi: (a) i proceseve të Bankës (harta e integruar e proceseve); (b) i rreziqeve operationale të qenësishme (inherente);
- Vlerësimi: (a) i rreziqeve i bazuar në metodologjinë e përzgjedhur; (b) i kontrolleve të vendosura për trajtimin e rreziqeve operationale inherente; (c) vlerësimi i rreziqeve operationale reziduale (pas kontrolleve) dhe përpilimi i hartës së integruar të rreziqeve;
- Ndjekja dhe raportimi i ecurisë së rreziqeve operationale dhe i masave / planeve të veprimit të ndërmarra;
- Auditimi dhe vlerësimi i pavarur;
- Hartimi i kuadrit rregullativ dhe qeverisja e procesit të ARO-s.

⁴⁸ IORWG- International Operational Risk Working Group for Central Banks.



C. Rritja dhe implementimi i kulturës së rrezikut operacional në nivel banke

Si njësi e sapokrijuar, krahas funksioneve të kryera në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut operacional, një nga objektivat dhe angazhimet kryesore për Zyrën ARO, ishte implementimi i mëtejshëm dhe rritja e kulturës së rrezikut operacional në nivel banke. Në kuadër të këtij angazhimi, janë zhvilluar disa trajnime/takime, duke filluar me drejtuesit dhe koordinatorët e njësisë organizative të BSH-së dhe duke vijuar me degët e Bankës së Shqipërisë.

Mbledhja e Raportimeve dhe Rezultatet e Para të Rrezikut Operacional

Fokusi i objektivave të Njesisë ARO për vitin 2017, është përqendruar në 3 hapa kryesorë, si më poshtë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të kulturës së rrezikut;
- Validimi objektiv i vlerësimit të rreziqeve dhe mundësisë së ndodhjes;
- Përcaktimi i planeve të veprimit, pasi të përcaktohet toleranca ndaj rrezikut nga KM-ja.

U saktësua mënyra e raportimit për incidentet e ndodhura pavarësisht impaktit të tyre.

Në përputhje me metodologjinë u dizajnuar një pjesë e KRI-së standarde (Treguesi Kyç i Rrezikut), e cila do të shërbejë për të matur dhe identifikuar rreziqet. Njësitë kanë filluar plotësimin gradualisht nga muaji nëntor e në vijim.

D. Maturimi i Administrimit të Rrezikut Operacional

Vlerësimi i përgjithshëm i maturitetit të Administrimit të Rrezikut Operacional në Bankën e Shqipërisë u bazua në modelin e maturitetit të dhënë nga IORWG, në udhëzimet e praktikave më të mira të administrimit të rrezikut operacional, si dhe në parimet bazë mbi Administrimin e Rrezikut Operacional në bankat qendrore dhe në Autoritetet e Mbikëqyrjes Monetare. Dokumenti i Parimeve të ARO-s përcakton kuadrin e ARO-s si një model me 5 shtylla:



Tabelë 6. Kategoritë e Modelit të Maturimit të Administrimit të Rrezikut Operacional sipas IORWG

KATEGORIA e 1^{RE}: KULTURA E RREZIKUT
- Niveli i angazhimit të Këshillit / Drejtimit të Lartë të Bankës
- Vendosja e tolerancës së rrezikut
- Integrimi i administrimit të rrezikut me aktivitetin e përditshëm
- Gjuha e njëjtë mbi rrezikun në Bankë
- Vlera e shtuar e ARO në Bankë
- Njohuritë e stafit të Bankës mbi metodologjinë e ARO
KATEGORIA e 2^{TE}: ORGANIZIMI DHE QEVERISJA
- Njohuria e aktorëve të ARO mbi përgjegjësitë e tyre
- Struktura qeverisëse e ARO
- Përgjegjësia për identifikimin dhe administrimin e rreziqeve
- Integrimi i procesit të ARO me funksionet dhe proceset e realizuara pranë njësie
- Përgjegjësia për mbikëqyrjen e rrezikut në Bankë
- Funksion / Strukturë e dedikuar për ARO në Bankë
- Përfshirja e administrimit të rrezikut midis funksioneve dhe njësive gjatë zhvillimit të strategjive
- Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi i funksionit të ARO me njësi të tjera kontrolli
- Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i qasjes së ARO
- Implementimi i modelit të tre linjave të mbrojtjes (kontrollit)
KATEGORIA e 3^{TE}: RAPORTIMI MBI RREZIKUN
- Raportimi periodik i informacionit (frekuenca, cilësia dhe vlera e shtuar)
- Raportimi periodik mbi rreziqet më të larta
- Niveli i përfshirjes së njësive për raportimin në kohë të informacionit
- Linjat e raportimit të raporteve të rrezikut
- Përmblajtja e raporteve mbi masat e minimizimit të rrezikut
- Matricë/hartë rreziqesh për agregimin e rreziqeve sipas impaktit/prioritetit/rëndësisë
- Parashikimi i taksonomisë së rrezikut në kuadrin e ARO
KATEGORIA e 4^T: PROCESI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT OPERACIONAL
- Përgjegjësia për monitorimin e planeve të veprimit për minimizimin e rrezikut
- Proces ARO i dizenuar i tillë që siguron identifikimin e rreziqeve operationale më relevante
- Proces për inventarin / regjistrimin e ngjarjeve të rrezikut
- Metodot e përdorura për identifikimin / vlerësimin e rreziqeve operationale
- Strategji për trajtimin e rreziqeve operationale të identifikuara
- Përdorimi i Treguesve Kyç të Rrezikut (KRLs) për monitorimin periodik të ekspozimit ndaj rrezikut
- Klasifikimi dhe menaxhimi i llojeve të ndryshme të rreziqeve
- Analiza kosto-përfitim në procesin e trajtimit të rrezikut
- Zhvillimi i planeve të vijueshmërisë për rreziqet më të larta
- Përfshirja në regjistrin e incidenteve e rreziqeve pothuajse të materializuara (<i>near misses</i>)
- Prioriteti i rreziqeve bazuar në vlerësimin e kombinuar të llojeve të rrezikut (<i>inherent /rezidual</i>)
KATEGORIA e 5^{TE}: OBJEKTIVI DHE REZULTATET
- Përdorimi i menaxhimit të incidenteve për minimizimin e ekspozimit ndaj rreziqeve operationale
- Praktikë adresimi e rezultateve të ARO në Këshill për vendimmarrje
- Përfshirja e rezultateve të ARO në planifikimin strategjik
- Bazë të dhënash për menaxhimin e incidenteve
- Përfshirja e rreziqeve të projekteve në procesin e ARO
- Hartë e proceseve për rreziqet e ndërlidhura / ndërvarura
- Marrja në konsideratë nga ARO e rreziqeve të tërthorta (transversale/horizontale)

Sipas metodologjisë së hartuar nga Grupi Ndërkombëtar i Punës për Rrezikun Operacional (IORWG), e prezantuar më parë, ecuria është në përputhje me pritshmëritë.

